



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Data:	05.12.2017
Referencë:	
Për:	Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti
Nga:	Drejtorati për Shërbime Publike
Lënda:	Raporti i muajit Nëntor 2017

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave gjatë muajit Nëntor 2017, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve.

Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin Nëntor				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
16	9		1	6

- Janë dhënë Vendime, përgjigje, pëlqime, njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Barazimi i të hyrave me kompaninë “Algemi” Sh.p.k e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet.
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM “Pastrimi” NjO Lipjan për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror Loti 1, mbikëqyrja kompanisë NTSH Durimi Prishtinë Loti 2, dhe mbikëqyrja e kompanisë EL BAU shpk Gjilan Loti i 3.
- Mbikëqyrja e kompanisë “Eing Com” e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera në qytetin e Lipjanit.
- 3 Kërkesa DBF për zotim të mjeteve.
- Kërkesë Drejtorisë së Inspektoratit për lirim të hapësirës publike nga objektet e përkohshme te vendosura ne sheshin Adem Jashari
- Është kërkuar nga NNT Eing Com për përgatitjet e duhura për pastrimin e hapësirave publike gjatë sezonit dimëror
- Kërkesë Drejtorisë së Prokurimit për inicim te procedurës për shërbimet e merimangës
- Është bërë njoftim stacionit policor dhe inspektoratit për dëmtim të hapësirave publike
- Kërkesë shërbimit pronësoro – juridik dhe DGJK-së për caktimin e pikave dhe definim të pronës në rrugën Msusi Elmi në fshatin Gllogovc
- Kërkesë KEDS-it për vendosje të ormanit të rrymës në shtyllë në rrugën Qamil Olluri.
- Janë përgatitë paramasa dhe parallogari.
- Pjesëmarrja në vlerësim të ofertave tenderuese në Drejtoratin për Prokurim.
- Asistimi në hartimin e projekteve detale.
- Mbikëqyrjet e punimeve të projekteve:

- Ndërtimi i sheshit Adem Jashari punimet janë duke vazhduar dhe janë në përfundim e sipër.
- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në disa fshatra - kolektori në Lipjan punimet kanë përfunduar, pritet pranimi teknik
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Ulët, punimet kanë përfunduar pritet pranimi teknik
- Ndërtimi i fushave te vogla sportive ne disa fshatra te komunës se Lipjanit, punimet janë duke vazhduar,
- Asfaltimi i rrugës Shalë, është bërë asfaltimi dhe pritet pranimi teknik.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Rubovc punimet kanë vazhduar me asfaltimin e rrugëve te mbetura, po vazhdohet me bankina
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Vrellë e Gadimes është bërë pranim teknik
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Kraishtë është bërë asfaltimi, pritet pranimi teknik
- Asfaltimi i rrugës Blinaj-Leletiq punimet janë duke vazhduar;
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Epërme, punimet janë duke vazhduar;
- Ndërtimi i zonës Industriale Qylag, punimet janë duke vazhduar
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Rubovc i Vogël, është bërë pranimi teknik,
- Asfaltimi i rrugicave në fshatin Glllogovc është bërë asfaltimi, po vazhdohet me ndërtimin e urës dhe punë tjera, pritet pranimi teknik
- Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Glllogovc, punimet janë duke vazhduar,
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Varigovc, është bërë pranimi teknik
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Akllap është bërë pranimi teknik
- Asfaltimi i rrugëve në Jeta e Re është bërë pranimi teknik.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dobrajë e Madhe punimet janë duke vazhduar
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Resinovc, punimet kanë përfunduar pritet pranimi teknik
- Asfaltimi i rrugës Topliqan – Vojnovc punimet janë ndërpre për shkak të motit të lig
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së.

Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr.
1	Kërkesa, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa te ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	10
2	Takime me përfaqësuesit e fshatrave	0
3	Përgatitja e paramasave dhe paralogarive	3
4	Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	0
5	Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	0
6	Takime zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës	0
7	Vizita në terren	111
8	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	0
9	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	1
10	Pranime teknike të projekteve të përfunduara	6